

## MENDIM PAKICE

Si anëtare e trupit gjykues nuk pajtohem me përfundimin e arritur nga ana e kolegëve të shumicës ('shumica') në rastin e rivlerësimit për subjektin znj. Lindita Hoxha, për arsytet e mëposhtme:

**1. Sa i përket pasurisë: apartament banimi me sipërfaqe 92 m<sup>2</sup>**, me nr. pasurie \*\*\*, i ndodhur në lagjen "\*\*\*\*", rruga "\*\*\*\*", Shkodër, në bashkëpronësi të G. A. dhe L. S., blerë me kontratën e shitblerjes me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol, datë 31.7.2006, në vlerën **2, 000, 000 (dy milion) lekë**, të likuiduara brenda zyrës së noterisë, ku, sipas shumicës, *arrihet në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare në krijimin e saj, pasi nuk provoi burimin e ligjshëm të të ardhurave të marra hua dhe pakësimin e gjendjes cash të përdorur si burim krijimi për këtë pasuri*, kam një qëndrim ndryshe.

Në vlerësimin tim, subjekti provoi gjatë hetimit administrativ se apartamenti i blerë prej saj është një apartament modest, në një pallat relativisht të vjetër, ndërtuar para viteve 90, (pas vitit 1979, ndërtuar me punë vullnetare) dhe se të gjithë banorët në ata pallat kanë blerë apartamentet në vlera të njëjta apo të përafërta.

Unë nuk pajtohem me mendimin e shumicës, e cila e konsideron pasaktësi mosdeklarimin nga ana e subjektit të identitetit të huadhënësit në deklaratimet periodike vjetore, pasi ajo ka deklaruar me saktësi të dhënat e tij në deklaratën "Vetting", duke përmbytur kështu edhe detyrimin për të treguar gjatë procesit të rivlerësimit lidhur me pasuritë e saj, si dhe personat e lidhur me të, në kuptim të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. Po ashtu, gjatë hetimit ka rezultuar në dokumentacionin e përcjellë nga dosja e ILDKPKI-së se ajo ka pyetur subjektin e rivlerësimit lidhur me këtë hua, e cila në vijim ka dorëzuar një deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 16.3.2015, ku z. S. B. deklaroi se i ka dhënë hua shtetasit G. A. shumën prej 1, 000, 000 lekë, me qëllim blerjen e një apartamenti dhe se detyrimi për këtë shumë është përmbytur në vitin 2007.

Lidhur me mundësitë financiare të huadhënësit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar gjatë hetimit, në mënyrë shteruese dhe me dokumentacion ligjor provues se, burim për krijimin e shumës së dhënë hua nga shtetasi S. B. bashkëshortit të saj, kanë shërbyer të ardhurat e fituara nga aktiviteti i tij tregtar. Sipas dokumentacionit të përcjellë me deklaratimet e saj, huadhënësi, sipas ekstraktit të QKB-së, rezultoi i regjistruar si person fizik nga data 15.10.2003, me NIPT: \*\*\*, me objekt: Bar - Bufë "\*\*\*\*". Gjithashtu, nga hetimi i Komisionit në QKB "online" rezultoi se, më 24.11.2005 është regjistruar shoqëria "\*\*\*\*" sh.p.k., me aksioner S. B. me NIPT: \*\*\*, i cili është ende biznes aktiv. Në vijim, huadhënësi ka pasur mundësi të zgjerojë aktivitetin e tij në të njëjtën periudhë në të cilën është dhënë huaja. Në përfundim, nga të dhënat e disponuara lidhur me qarkullimin nga aktiviteti si person fizik, të marra nga organet kompetente, për të cilat rezultoi i paguar edhe tatimi përkatës, rezultoi se, huadhënësi ka patur mundësi financiare për dhënien e kësaj huaje edhe pa i konsideruar të ardhurat nga aktiviteti i regjistruar si sh.p.k., por vetëm ai si person fizik, tregtar. Në vlerësimin tim, subjekti i rivlerësimit nuk mund të hetojë lidhur me mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë tregtare të huadhënësit, pasi në bindjen e saj duket se aktiviteti i ushtruar dhe xhiroja e deklaruar kanë qenë të mjaftueshme për të qenë e garantuar se ai ka patur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për dhënien e huas, situatë e cila ka rezultuar edhe nga hetimi i Komisionit.

Në vlerësimin e këtij burimi duhet mbajtur në konsideratë edhe fakti se subjekti i rivlerësimit ka shlyer këtë hua nëpërmjet një kredie bankare të marrë pranë "Raiffeisen Bank" në datën 12.12.2007 me vlerë 1,000,000 lekë dhe nga hetimi rezultoi se përputheshin dokumentet e mbledhura gjatë hetimit me deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike lidhur me shlyerjen e kësaj huaje. Subjekti duket se ka marrë një kredi konsumatore dhe të shpejtë, kjo edhe nga norma e lartë e interesit të kësaj kredie në masën 18%. Vetë subjekti ka deklaruar në DPV/2006 se ka marrë këtë kredi për shlyerjen e borxhit të deklaruar më parë.

Lidhur me deklarimin e subjektit të rivlerësimit për përdorimin e *overdraftit* si burim për pasurinë e mësipërme, nga hetimi rezultoi se ai është përdorur rreth 10 ditë më vonë se data e lidhjes së kontratës, porse rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka kërkuar miratimin e *overdraftit* dhe ka

përdorur atë pikërisht në këtë periudhë. Edhe vetë subjekti rivlerësimin në DPV-në e vitit 2006 ka deklaruar se *overdrafti* është marrë në datën 20.8.2006 e se ai ka shërbyer për të shlyer pagesat e kryera për blerjen e pasurisë së mësipërme.

Lidhur me kursimet e përdorura të siguruara nga puna ndër vite në vlerën 750, 000 lekë, subjekti ka shpjeguar, sikurse ka deklaruar edhe në deklaratën “Vetting”, se ato janë kursime të saj dhe bashkëshortit nga puna. Referuar pyetësorit të datës 8.1.2020, subjekti ka shpjeguar se, shuma e kursimeve të cilat ka pasur gjendje në kohën e blerjes së apartamentit në datën 31.7.2006, ka qenë në vlerën 750, 000 lekë.

Në deklaratën para fillimit të detyrës, në vitin 2003 subjekti nuk deklaroi gjendje *cash*, në deklarimin e vitit 2004 subjekti ka deklaruar 500,000 lekë kursime dhe në deklaratën e vitit 2005 ka deklaruar “shtuar 700,000 lekë kursime”.

Mbështetur në analizën financiare të kryer nga njësia ligjore për periudhën paraardhëse, subjekti ka pasur mundësi financiare të kursejë vlerën e deklaruar të parave prej 700,000 lekë në fund të vitit 2005. Nga analiza financiare rezultoi se, deri në momentin e blerjes së pasurisë subjekti ka pasur mundësi të kursejë vlerën prej 50,000 lekë.

Në total, konsideruar kursimet e deklaruara të vitit 2005 dhe kursimet deri në korrik 2006, vlera e kursimeve të subjektit, e mundshme për t’u përdorur për blerjen e apartamentit, është në shumën 1,160,475 lekë. Nga sa rezulton se kursimet e subjektit dhe huaja e marrë ndaj shtetasit S. B. janë të mjaftueshme për krijimin e pasurisë së mësipërme.

Lidhur me mosdeklarimin e pakësimit të gjendjes *cash* në vitin 2006 të konstatuar si pasaktësi nga shumica, rezulton se subjekti ka deklaruar atë si një pakujdesi, e cila e vlerësuar në tërësinë e deklarimeve të subjektit dhe atij “Vetting” lidhur me gjendjen *cash*, rezulton se është e tillë, pasi nuk është përdorur në asnjë moment të mëvonshëm apo për shtimin e ndonjë pasurie. Po ashtu, në këtë vlerësim duhet mbajtur në konsideratë edhe kronologjia e deklarimeve të subjektit ndër vite. Në vitin 2006, kur edhe ka blerë pasurinë, subjekti ka deklaruar shumën 1.000.000 lekë borxh, çka do të thotë se asaj nuk i kanë mjaftuar të ardhurat e saj (kursimet *cash* të deklaruara më parë) dhe ka marrë edhe një hua. Po ashtu, në DPV-në pasuese, ajo nuk deklaroi në vijim në asnjë prej tyre kursime *cash*, as shtesa, dhe as pakësime deri në vitin 2012, ku subjekti deklaroi në deklarimin periodik vjetor “*gjendje parash cash shumën 370.000 lekë me burimin kursime nga të ardhurat e përbashkëta*”.

Në vlerësim të të gjitha deklarimeve, Komisioni ka bërë analizën financiare, duke llogaritur lidhur me mundësitë e subjektit për të patur kursime në shumën 370, 000 lekë nga të ardhurat e atij viti dhe e ka vendosur këtë vlerë si gjendje të kursimeve *cash* në vitin 2012. Në një vlerësim të përgjithshëm të shpjegimeve të subjektit, si dhe deklarimeve periodike vjetore, deklarimit “Vetting” dhe dokumentacionit të mbledhur gjatë hetimit trupi gjykues, në një vlerësim të drejtë, propocional dhe objektiv të çështjes, duhet të kishte arritur në konkluzionin se subjekti ka shpjeguar mjaftueshëm dhe se shpjegimet e saj përputhen me deklarimet ndër vite, duke e konsideruar këtë pasuri si të krijuar me burime të ligjshme dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**2. Lidhur me pasurinë ndërtimi informal në fshatin \*\*\***, komuna Rrethina Shkodër, i cili nuk është në përdorim, aplikuar për legalizim me kërkesën nr. \*\*\*, datë 19.7.2013, nuk bie dakord me shumicën për konkluzionin e arritur në këtë rast, duke arsyetuar sa më poshtë.

Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit, të cilat kanë shërbyer si burim për ndërtimin e kësaj pasurie, Komisioni, gjatë hetimit administrativ, mbajti korrespondencën me kompaninë e sigurimeve “\*\*\*”<sup>1</sup>, nga ku u vërtetua edhe nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.a. marrëdhënia e qiramarrjes me shtetasin G. Xh. A., e cila deklaroi se ajo, (kompania) kishte paguar edhe tatimin mbi të ardhurat e qiradhënësit, në burim. Shoqëria e sigurimeve bashkëngjiti kopjet e kontratave të qirasë (me nr. \*\*\*, datë 1.1.2013, në shumën prej 44,444 lekë/muaj dhe kontrata e qirasë me nr.\*\*\*, datë

<sup>1</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot, datë 23.1.2020 nga “\*\*\*\*” sh.a. (dosja e Komisionit)

1.3.2014, në vlerën prej 33,333 lekë/muaj). Nga hetimi i llogarive bankare të bashkëshortit të subjektit rezultoi se, pagesat ishin kryer nëpërmjet bankës dhe se vlerat e pagesës së qirasë, të derdhura në llogarinë bankare pranë “RFZ”, ishin më të vogla se vlera e deklaruar në kontratën e qiramarrjes, pasi është mbajtur tatimi në burim nga ana e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a. Gjithashtu, në kontratë ishte përcaktuar se pagesa e detyrimeve tatimore do të bëhej nga qiramarrësi, shoqëria “\*\*\*\*” sh.a., parashikim ky edhe sipas nenit 33 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

*Bazuar në sa më sipër, të dhënat dhe provat e administruara nga hetimi administrativ, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit arriti të provojë se pagesat e kryera në periudhën 2013- tetor 2014 janë në vlera neto dhe se ato duhen pranuar si të ardhura të ligjshme. Parashikimet e legjislacionit të kohës përcaktojnë mbajtjen në burim të detyrimeve tatimore, marrëdhënie e cila ka rezultuar edhe e provuar me veprimet e njëpasnjëshme të kryera nga palët.*

**Lidhur me situatën e konfliktit të interesit mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a., për shkak se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar** çështjet gjyqësore me palë ndërgjyqëse “\*\*\*\*” sh.a., gjatë periudhës 2008 – 2014, si:

- Vendimi nr. \*\*\*, datë 28.5.2008 (me paditës: S. M., i paditur: “\*\*\*\*” sh.a., Tiranë dhe Dega Shkodër, me objekt: “Shpërblim dëmi kontraktor në shumën 1,023,051 lekë”, shumë kjo e cila pretendohet se duhej të ishte shlyer nga pala e paditur. Në këtë vendim, Gjykata e Apelit Shkodër vendosi pranimin pjesërisht të padisë, duke e detyruar palën e paditur “\*\*\*\*” sh.a., Tiranë të paguajë në favor të paditësit shumën prej 621, 507 lekë);

- Vendimi nr. \*\*\*, datë 10.10.2013 (me paditës: “\*\*\*\*” sh.a., i paditur: A.T., me objekt: “Kthimin nga ana e të paditurit të shumës prej 10.008.48 euro”. Në këtë vendim, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe rrëzimin e padisë);

- Vendimi nr. \*\*\*, datë 24.03.2014 (me paditës: B.M., i paditur: “\*\*\*\*” sh.a., me objekt: “Dëmshpërblim pasuror dhe jopasuror të shkaktuar nga vdekja e të ndjerit, S.M., si pasojë e qarkullimit të mjeteve motorike”. Në këtë vendim, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë kësaj gjykate me tjetër trup gjykues);

Nuk jam dakord me arsyetimin e shumicës së trupit gjykues, pasi, shtetasi G. A. (bashkëshorti i subjektit) nuk ka patur ndonjë marrëdhënie të veçantë të një interesi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë lidhur me këtë shoqëri, pasi ishte ajo e cila ka shprehur interesin për marrjen me qira të një objekti modest, i cili as nuk ishte në pronësi të z. G. A.. Vetëm kjo marrëdhënie nuk mund të përbëjë shkak për marrëdhënie të mundshme të konfliktit të interesit, për të cilat subjekti i rivlerësimit duhej të tërhiqej nga gjykimi i çështjes.

Nëse vlerësohet edhe qëndrimi i subjektit lidhur me zgjidhjen e çështjeve, po ashtu të krijohet bindja se ajo as nuk ka patur dijeni dhe as nuk është përpjekur të favorizojë në ndonjë mënyrë bashkëshortin e saj apo shoqërinë e sigurimeve, apo të krijojë ndonjë marrëdhënie të mëvonshme interesash.

Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka qenë më vonë një i punësuar, siç mund të jenë edhe shumë e shumë qytetarë të tjerë, çka në vlerësimin tim, nuk përbën shkak të mjaftueshëm për një konflikt të mundshëm të interesit apo për një konflikt në dukje të tij, dhe aq më tepër, një shkak shkarkimi për subjektin e rivlerësimit, në kuptim të nenit 33 pika 5 germa “d” të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me huan e marrë nga shtetasi B. H. në shumën 400.000 (katër qind mijë) lekë, rezulton e deklaruar në DPV-në e vitit 2013. I pyetur subjekti lidhur me burimin e të ardhurave, rezulton se ato janë nga aktiviteti i tij bujqësor dhe të ardhura nga emigracioni i fëmijëve të tij. Për të provuar këtë fakt, subjekti ka paraqitur dokumentat e pronësisë së tokës për shtetasin B. H.. Në vlerësimin tim, pamundësia e subjektit të rivlerësimit për të provuar burimin e ligjshëm të huadhënësit, lidhet me faktin se të ardhurat nga personat e vetëpunësuar në bujqësi e blegtori, nuk i nënshtrohen legjislacionit tatimor e si rrjedhojë ato nuk mund të provohen lehtësisht, ama nisur nga aktiviteti

bujqësor si dhe shuma prej 400.000 (katër qind mijë) lekë dhënë hua, besohet se huadhënësi duhet të ketë patur mundësi.

Po ashtu në analizën financiare të vitit 2013, nëse nuk do të merrej në konsideratë si e ardhur, huaja e deklaruar nga shtetasi B. H., subjekti përsëri do të rezultonte me një balancë pozitive në vlerën 18.500 (tetëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë, ndërkohë që huaja në shumën prej 400.000 (katër qind mijë) lekë, është përfshirë në analizën financiare të vitit 2014 si kthim huaje dhe subjekti ka rezultuar me balancë pozitive.

Në vlerësimin tim kjo situatë nuk mund të përbëjë shkak për shkarkimin e subjektit nga detyra, pasi ajo nuk klasifikohet në asnjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 33 të ligjit nr.84/2016.

Vetë ndërtimi informal, në fshatin \*\*\*, për të cilin subjekti ka paraqitur foto të objektit, të krijon bindjen se është një investim modest, në përpjekje për të organizuar një veprimtari tregtare për rritjen dhe mbarështimin në formë natyrore të shpendëve, kryesisht pula dhe pata, në një teren të njohur për bashkëshortin e subjektit. Nga vetë bilancet e shoqërisë tregtare, duket se shoqëria kryente aktivitet tregtar me qarkullim modest, shuma të cilat riinvestoheshin në shoqëri për shpenzime lidhur me këtë aktivitet dhe se asnjëherë subjekti nuk kishte deklaruar fitime nga ky aktivitet i bashkëshortit. E gjithë kjo tablo të krijon bindjen se kjo veprimtari e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit ishte një përpjekje modeste e tij për të ushtruar një veprimtari tregtare, që mund të gjenerojë të ardhura, për të cilën as nuk mund të mendohet se ndodhemi në ndonjërin nga kushtet e nenit 33 të ligjit nr.84/2016 apo në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

**3. Pasuria apartament banimi me sip. 64.35 m<sup>2</sup>, në Shëngjin, Lezhë, blerë sipas kontratës së sipërmarrjes midis shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe z. G. A., në vlerën 35.400 euro.** Nuk jam dakord me konkluzionin e arritur nga shumica se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare të paguajë këstin e parë të apartamentit në vlerën 1.352.700 (një milion e treqind e pesëdhjetë e dy mijë e shtatëqind) lekë, duke e lidhur këtë arsyetim me mosdeklarimin nga ajo të pakësimit të gjendjes së saj të kursimeve *cash* dhe vlerësoj se ai është një interpretim i gabuar i ligjit.

Vetë subjekti në deklaratën periodike të vitit 2016 ka deklaruar se ka paguar këstin e parë në datën 30.3.2016, në shumën 10.000 euro, nga kursime gjatë vitit 2015 të deklaruara më parë, duke deklaruar në vijim se gjendja *cash* në 31.12.2016 është në shumën 680,000 lekë, si dhe burimin e tyre nga të ardhurat nga paga. Po ashtu, edhe në deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar se burim për pagesën e këtij apartamenti kanë shërbyer të ardhurat nga kursimet *cash* të deklaruara ndër vite dhe se gjendja *cash* është në shumën 720.000 lekë, ku përfshihet një shtesë prej 40.000 lekë për muajin janar të vitit 2017.

Në referim të deklarimeve të subjektit, si dhe në vlerësimin në tërësi të deklarimeve të saj vërehet se ajo ka deklaruar burimin për krijimin e kësaj pasurie. Vlerësimi mbi saktësinë e deklarimeve *cash* të subjekteve duhet të bëhet në tërësinë e tyre (deklarimeve periodike vjetore dhe atij “Vetting”) dhe jo referuar vetëm vitit të deklarimit. Po ashtu pasktësia në deklarim lidhur duhet vlerësuar lidhur me përpjekje të mundshme të subjektit për të fshehur pasuri apo për të mbuluar shpenzime të padeklaruara.

**4. Lidhur me mundësitë financiare për blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*”, në vitin 2010 në vlerën 5.000 euro + 400.000 lekë pagesë për doganën, deklaruar në deklaratën “Vetting”, se është blerë me kursime dhe hua të marrë shtetasve B. J. (në vlerën 1.000 euro) dhe R. J. (në vlerën 4.000 USD).**

Në të dy rastet, nga hetimi provohej veprimtaria tregtare e këtyre shtetasve (huadhënësve), si dhe të ardhurat e tyre, të cilat, në vlerësimin tim janë të mjaftueshme për të krijuar bindjen se subjekti ka patur mundësi financiare me burime të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie dhe se ajo ka përmbushur detyrimin sipas nenit 32 të ligjit nr.84/2016, për të provuar mundësitë financiare të huadhënësve.

Lidhur me mënyrën e deklarimit në DPV-në e vitit 2010 “e blerë pjesërisht nga të ardhurat personale dhe pjesa tjetër në *cash*” subjekti ka shpjeguar qartë në deklaratën “Vetting” se shuma

në *cash* është hua e marrë nga bashkëshorti i saj tek vëllezërit e tij. Subjekti ka sqaruar në deklaratën “Vetting” lidhur me deklaratimet e saj, duke përmbushur kështu edhe detyrimet që rjedhin nga ligji nr. 84/2016. Po ashtu, nëse verifikohen deklaratimet e bëra në “Vetting” me ato në DPV-të përkatëse, nuk rezulton deklarim i rremë apo i pamjaftueshëm në kuptim të nenit 33, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, por vetëm se subjekti ka sqaruar hollësisht (në mënyrë të detajuar) deklaratimet e bëra prej saj në deklaratimet periodike vjetore e se ajo nuk ka ndryshuar deklaratimet në asnjë rast.

Në përfundim, nuk jam dakord me konkluzionet e arritura nga shumica e trupit gjykues lidhur me këtë pasuri.

5. Në një vlerësim të përgjithshëm të çështjes arrij në përfundimin se pasaktësitë e konstatuara gjatë hetimit nuk janë të tilla që të përmbushin kërkesat e nenit 33, pika 5, të ligjit nr.84/2016. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në kohë dhe sipas ligjit, duke pasqyruar saktë dhe në mënyrë të detajuar të dhëna të paraqitura në deklaratimet e saj ndër vite, duke përmbushur kështu detyrimin për deklarim të saktë dhe në përputhje me ligjin në deklaratën “Vetting”. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting” në asnjë rast nuk bien ndesh me deklaratimet periodike vjetore të dorëzuara prej saj dhe se pasaktësitë e konstatuara në DPV-të nuk mund të përbëjnë shkak për shkarkimin e subjektit nga detyra kur ato rezultojnë të paqëllimshme.

Në një vlerësim të përgjithshëm të të gjithë pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, si dhe shpenzimeve të kryera e stilit të jetesës, vërehet se pasaktësitë e dala në pah, kanë të bëjnë me bashkëshortin e subjektit dhe se në asnjë rast nuk të krijojnë dyshime se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehë pasuritë apo t’i paraqesë ato në mënyrë të pasaktë e se asnjë nga deklaratimet e subjektit të deklaratën “Vetting” nuk rezultoi i pasaktë apo i pamjaftueshëm.

Gjatë hetimi nuk u konstatua asnjë indicje, fakt apo rrethanë, e mbledhur nga pjesëmarrja e publikut në denoncimin e fakteve, që mund të përbëjë provë në lidhje me kriteret e rivlerësimit. Po ashtu, në të gjitha hetimet e Komisionit lidhur me subjektin e rivlerësimit, ka rezultuar se ajo ka integritet të lartë në punë dhe se nuk vihet lehtësisht nën presion nga strukturat kriminale.

Për këto arsye, në një vlerësim të përgjithshëm të të tre kriterëve për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.84/2016, qëllimi i të cilit është rivlerësimi kalimtar i subjekteve, me qëllim garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek drejtësia, nëpërmjet një vlerësimi tërësor, objektiv dhe proporcional, si dhe mbështetur në parimin e gjykimit të drejtë, kam bindjen se subjekti i rivlerësimit Lindita Hoxha duhej të konfirmohej në detyrë, duke u zbatuar neni 59, pika 1, e ligjit nr. 84/2016.

**ANËTARE**

**Valbona SANXHAKTARI**